



UNIVERSITETI I TIRANËS
Senati Akademik

VENDIM

Nr.6 datë 26.4.2017

“Për miratimin e disa rregullave lidhur me aplikimin e tarifave të shkollimit për programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve, për vitin akademik 2016-2017”

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” në nenin 3 pika 3 gërma ç), nenin 38 pikat 1 dhe 3, neni 98 pika 2 gërma c), Statutin e Universitetit të Tiranës neni 19, si dhe në propozimet e Rektoratit të UT-së, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 26.04.2017;

VENDOSI:

1. Studentët e programeve të ciklit të parë i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi, atë të vitit përkatës.
2. Studentët e programeve të ciklit të parë të cilësuar përsëritës sipas Rregullores së Universitetit të Tiranës, paguajnë tarifën për kredit të lëndëve përsëritëse, por jo më shumë se tarifa vjetore e shkollimit.
3. Studentët e programeve të ciklit të dytë, brenda kohëzgjatjes normale të programit të studimeve, i nënshtrohen vetëm një tarife vjetore shkollimi, atë të vitit përkatës.
4. Studentët e programeve të ciklit të dytë të cilësuar përsëritës sipas Rregullores së Universitetit të Tiranës paguajnë tarifën për kredit të lëndëve përsëritëse, kur janë mbi kohëzgjatjen normale të programit të studimeve, por jo më shumë se tarifa vjetore e shkollimit.
5. Përfshihen nga pagesa sipas pikës 5 më sipër, kreditet e provimit të diplomës.
6. Studentët e cilësuar të shkëqyer sipas Rregullores së Universitetit të Tiranës në ciklin e parë të studimeve, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit në vitin e parë në programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”. Studentët në programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” të cilët përfundojnë vitin e parë me notë mesatare 10, përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit në vitin e dytë të këtij programi.
7. Ngarkohen Kancelari i Universitetit të Tiranës dhe Kancelarët e fakulteteve të përllogarisin efektet financiare nga ky vendim.
8. Ky vendim i dërgohet Bordit të Administrimit për miratimin përfundimtar të buxhetit të vitit 2017 të Universitetit të Tiranës.

KRYETARI

PROF. DR. MYNYR KONI